

	
ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njësia:	KO
Unit:	
Jednica:	
Nr. i faqeve:	
No. of pages:	-02-
Br. stranica:	
Mr. Prot.:	
Prot. No.:	02/2019
Br. Prot.:	
Data:	
Datum:	18.01.2019
Prishtinë	



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF 02/2019

KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.12 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenin 22, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.12 dhe 1.14 dhe Nenit 53, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të OMK-së dhe Nenit 23, paragrafit 2 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 17 janar 2019, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KUOTËS SË ANËTARËSISË

Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët në Republikën e Kosovës

- I. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët e punësuar në institucione publike dhe private, për mjekët e pensionuar që ushtrojnë veprimtarinë mjekësore si të punësuar, specializantët, mjekët e papunë dhe mjekët nga Lugina e Preshevës, në shumë prej 80.00 (tetëdhjetë) € (euro);
- II. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët me shtetësi kosovare të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë vendit dhe dëshirojnë vullnetarisht të regjistrohen dhe të anëtarësohen në Odë, në shumë prej 80.00 (tetëdhjetë) € (euro);
- III. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët me shtetësi të huaj në shumë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjet) € (euro);

Mënyra e ekzekutimit të pagesës së kuotës së anëtarësimit vjetor

- I. Të gjithë mjekëve të cilët punojnë në institucionet shëndetësore publike do t'iu bëhet ndalesa automatike e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore jo më larg se data 1 e muajit mars të vitit kalendarik përmes sistemit të pagave-Payroll.
- II. Të gjithë mjekëve të cilët punojnë në institucionet shëndetësore private, mjekët e pensionuar që ushtrojnë veprimtarinë mjekësore si të punësuar, të gjithë specialistët, mjekët e papunë dhe mjekët nga Lugina e Preshevës obligohen që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjnë jo më larg se data 1 e muajit mars të vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .
- III. Të gjithë mjekët qytetar jo Kosovarë të cilën ushtrojnë veprimtarinë mjekësore në Republikën e Kosovës, obligohen që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjnë jo më larg se data 1 e muajit mars të vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .
- IV. Të gjithë mjekët me shtetësi kosovare të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë vendit që vullnetarisht anëtarësohen në OMK, obligohen që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjnë jo më larg se data 1 e muajit mars të vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .

Pasojat juridike për shkelje të obligimit të anëtarësimit

Të gjithë mjekët që nuk i kryejnë obligimet sipas këtij Vendimi, lidhur me pagesën e kuotës së anëtarësisë mund t'i shqiptohet masa disiplinore apo edhe gjoba shtrënguese konform Rregulloreve të OMK-së si dhe konform legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Hyrja në fuqi

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat që kanë përcaktuar lartësinë e taksave administrative në OMK.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i OMK-së.

Prishtinë, 17.01.2019

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. sci

